



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 114, Datë 22.07.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “S.P.E GJADËR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GJADËR NR. 1/1” ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 2134 KW, HEC “GJADËR NR. 1/2” ME KAPACITET  
TË INSTALUAR 4406 KW, HEC “GJADËR NR. 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR  
2983 KW, HEC “GJADËR NR. 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3874 KW, HEC“  
GJADËR NR. 4” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922 KW, HEC“ GJADËR NR. 5”  
ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 KW, ME KAPACITET TOTAL TË  
INSTALUAR 24938 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma” a”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.06.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “S.P.E GJADËR“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “S.P.E GJADËR” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga Hec “GJADËR nr. 1/1” me kapacitet të instaluar 2134 KW, Hec “GJADËR nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 KW, Hec “GJADËR nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 KW, Hec “GJADËR nr. 3”, me kapacitet të instaluar 3874 KW, Hec “GJADËR nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 KW, Hec “GJADËR nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 KW, me kapacitet total të instaluar 24938 KW.

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 48, datë 27.03.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: “HEC Gjadër Nr.1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, “HEC Gjadër Nr.1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, “HEC Gjadër Nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, “Hec Gjadër Nr.

3” me kapacitet të instaluar 3874 kW, “HEC Gjadër Nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, “HEC Gjadër Nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW me kapacitet të instaluar total 24938 kW, për një afat 30 vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 32/11 Prot., datë 27.03.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezulton të ketë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën nr. 195/1 prot., datë 27.03.2019, ka përcjellë pranë shoqërisë kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar, i cili konsiston si më poshtë:
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (Neni 9, pika 2)
    - **gërma “d”** (vertetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë),
    - **gërma “e”** (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (ne perputhje me aktivitetin për të cilin kerkohet licenca),
    - **gërma “g”** (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);
    - Neni 9, pika 3: **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit),
  - Dokumentacioni teknik dhe grafik (Neni 9, pika 4.1.3)
    - **gërma “c”** Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër rregjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000.
- Shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 195/2 Prot, datë 18.04.2019, ka përcjellë një pjesë të dokumencionit të munguar dhe në këto kushte, ERE me shkresat nr. 195/3 Prot., datë 06.05.2019 dhe nr. 195/5 Prot., 27.05.2019, ka vijuar kërkesat për plotësim dokumentacioni. Shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k, ka plotësuar dokumentacionin e mbetur me shkresat nr. 195/4 Prot., datë 16.05.2019 dhe nr. 195/6 Prot., datë 31.05.2019.
- Shoqëria ka paraqitur në ERE Raportin e Oponencës Teknike nr. 5476 Prot, datë 20.05.2015, mbi projektin e zbatimit të HEC “Gjadër”.
- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e ZVRPP Lezhë me nr. 5184/1 Prot, datë 24.11.2015, e cila njofton shoqërinë se është rregjistruar kontrata e koncesionit në pasuritë e listuara në këtë shkresë sipas numrave përkatës të pasurive, përveç pasurisë me nr. 33/9 vol 1, faqe 46, me sipërfaqe 5350 m2, me emërtesë “arë” e cila nuk preket nga vepra. Numrat e pasurisë janë të shoqëruara me kartelat e pasurisë me përshkrimin në referencë të kontratave të koncesionit.

- Shoqëria ka paraqitur Lejen e përdorimit të ujqor, referuar shkresës së Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujqit nr. 549 Prot., datë 01.11.2016.
- Pas shqyrtimit në mbledhjen e Bordit të ERE, të datës 21.06.2019, u ngritën pyetje e u lanë detyra për sqarime në lidhje me Lejen e ndërtimit të lëshuar me Vendimin e KKT me nr. 9, datë 09.09.2015, statusin e ndërtimit të veprave prodhuese si dhe deklaratës së shoqërisë në lidhje me kërkesën që do të adresojë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zgjatjen e afatit të kontratës, pas zbardhjes së lejes së ndërtimit nga AZHT.
- ERE më shkresën nr. 195/7 Prot., datë 25.06.2019, dërgoi pranë shoqërisë njoftimin për zhvillimin e një seance dëgjimore për të sqaruar sa më sipër.
- Në seancën dëgjimore të datës 28.06.2019, përfaqësuesi i shoqërisë sqaroi në lidhje me çështje që lidheshin më plotësimin e kushteve të parashikuara në kontratën e konçesionit si më poshtë :
  - Kontrata e Konçesionit *bazë me Nr.10328rep ,Nr.3322 kol e nënshkruar ne date 09.09.2013 në nenin 10* të saj **pika 10.1** parashikon se “Konçencionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit . Aplikimi për pajisjen me leje ndërtimi do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektzbatimit përfundimtar nga Autoriteti kontraktues. **Pika 10.2** Konçencionari merr persiper të vërë në punë hidrocentralin brenda 18 muajve nga data e marrjes së lejes zhvillimore komplekse. Afati për pajisjen me lejen e nevojshme është jo me shumë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së Konçesionit sic parashikuar në dokumentat standarte të garës. Afati i punimeve është parashikuar në grafikun e punimeve në aneksin 2, bashkëlidhur. **Pika 10.3** Këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktor dhe Konçencionarit nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proceduriale për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonësës të krijuar nga subjektet shtetërore.
- Me kontratën nr. 328 rep nr 176 kol, datë 17.06.2015 është miratuar kontrata shtesë e konçesionit.
- Shoqëria në zbatim të **nenit 10** të kontratës së Konçesionit, ka vijuar me aplikimin për lejen e ndërtimit e cila i është miratuar me Vendimin Nr.09 datë 09.09.2015 ku në pikën 2 të kësaj leje të Vendimit të KKT përcaktohet se “Kusht për miratimin e lejes së ndërtimit, është pajisja me Vendimin e Këshillit të Basenit Ujqor për përdorimin e Burimeve ujqore”.
- Shoqëria me tej është pajisur me Lejen e Ujqit nga KKT me Vendimin me NR.14 datë 26.10.2016 dhe ka vijuar me depozitimin e saj në KKT.
- Shoqërisë i është kërkuar të riaplikojë pranë Agjensisë së Zhvillimit të Territorit, nëpërmjet platformës elektronike në zbatim të legjislacionit në fuqi, dhe sic dokumentohet në datë 12.05.2019 është kryer aplikimi nëpërmjet kësaj platforme duke kërkuar lëshimin e lejes së zbardhur të ndërtimit.
- Me zbardhjen e lejes së ndërtimit do të fillojnë dhe punimet e veprës të cilat parashikohen të përfundojnë deri në fund të vitit 2019, pasi shoqëria ka siguruar të gjithë bazën materiale si dhe pajisjet teknike.

Deri në fund të vitit 2019 parashikohet të ndërtohen dhe të vihen në punë 3 HEC-e.

- Aplikimi i shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
  - **Formati i aplikimit** (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - **Dokumentacioni teknik** (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Kontrata e Koncesionit e formës BOT e lidhur midis METE (sot MIE) dhe Bashkimit të Shoqërive “Ani” sh.p.k, “Rafaelo 2002” sh.a, “Junik” sh.p.k, “Vllaznimi” sh.p.k, “S.P.E Energy” sh.p.k “EUES Energy” sh.p.k, ka një afat 35 vjeçar, që fillon nga data 09.09.2013. Shoqëria ka aplikuar në ERE për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në datën 28.02.2019. Nga analiza e afateve të llogaritura sipas kontratës së Koncesionit dhe periudhës 30 vjeçare që ERE lëshon një licencë në zbatim të nenit 38 të Ligjit *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, i ndryshuar dhe nenit 5 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, rezulton se nga koha e nënshkrimit kanë kaluar 5 vjet e 10 muaj. Në këto kushte, ERE mund të lëshojë një licencë për një afat deri në 29 vjet e 2 muaj për këtë shoqëri, në përputhje me periudhën e mbetur të koncesionit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “S.P.E Gjadër” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: “HEC Gjadër Nr.1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, “HEC Gjadër Nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, “HEC Gjadër Nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, “Hec Gjadër Nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 kW, “HEC Gjadër Nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, “HEC Gjadër Nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW; me kapacitet të instaluar total 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve të dokumentojë marrjen e lejes së ndërtimit të zbardhur.
2. Në çdo rast që Autoriteti Kontraktor do të shprehet me vendim për shtyrje të afatit të ndërtimit dhe vënies në punë të veprës, shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k t’i drejtohet ERE-s për miratimin e ndryshimeve që do të prodhojë kontrata shtesë e koncesionit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**